



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0012907-1/24 dt. 28.02.2024

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja e 26

Koha: 28.02.2024 ora 10:00
Vendi: Salla e Mediave
Të pranishëm: Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja
Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Vesel Neziri, Shkurta Shosholli Musa, Hysen Muzliukaj, Erseka Barani, Muhamed Hoti dhe Xhyljeta Imeri
Drejtorët e Drejtorive

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja e cila theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11 paragrafët: 1, 2 edhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë; nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, për sot ka thirrur mbledhjen e njëzetetjash të Komitetit për Politikë dhe Financa, me rendin e ditë të paraparë me thirrje.

Në vazhdim Kryesuesja u tha anëtarëve të KPF-së se me e-mail iu ka ardhur Plani i punës së Kryetarit për vitin 2024 i cili propozohet të hyjë në rend dite, po ashtu para vetës keni edhe Kërkesën e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare, e cila po ashtu propozohet të hyjë në rend dite.

Kryesuesja hapi diskutimin për rendin e ditës.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesja vuri në votim propozimin që pikë e 5-të e rendit të ditës të jetë Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.

Komiteti për Politikë dhe Financa unanimisht miratoi propozimin që pikë e 5-të e rendit të ditës të jetë Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.

Kryesuesja vuri në votim propozimin që pikë e 6-të e rendit të ditës të jetë Kërkesa e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare.

Komiteti për Politikë dhe Financa unanimisht miratoi propozimin që pikë e 6-të e rendit të ditës të jetë Kërkesa e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare.

Në vazhdim Kryesuesja vuri në votim këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Projekt-Plani komunal për shërbime sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut
3. Projekt-Plani i veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026
4. Raporti i punës së Drejtorisë për Shëndetësi për periudhën janar-dhjetor 2023
5. Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024
6. Kërkesa e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare

Rendi i ditës u miratua unanimisht.

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht.

Pika 2

Kryesuesja znj. Vesa Broja hapi diskutimin lidhur me Projekt-Planin komunal për shërbime sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja vuri në votim Projekt-Planin komunal për shërbime sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Projekt-Plani komunal për shërbime sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut u miratua unanimisht (9-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Projekt-Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026.

Fadil Veseli: Në faqen 11 të Planit e pashë tabelën me numrin e nxënësve që braktisin shkollën, nuk është alarmante, alarmante dhe shqetësuese është rezultati i dobët në PISA, të gjithë duhet të ndjehemi keq, askush nuk po merret me këtë çështje, ku është problemi për këto rezultate të dobëta, e di që kjo çështje i takon nivelit qendror, por është mirë të bëhet një Strategji gjithëkombëtare se si të dalim nga kjo situatë.

Vesel Neziri: Problemet nuk lindin brenda ditës, problemi lind në familje, braktisja në shkolla vije si rezultat se po shkelen të drejtat e fëmijëve, mosmarrëveshjet ndërmjet prindërve e sidomos divorcet e kanë sjellë këtë situatë, sepse nxënësit që e braktisin shkollën janë fëmijë të prindërve të ndarë.

Hysen Muzliukaj: Plani i veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026 është i mirëpritur, por problemi për mos interesim për mësim vije për shkak se nuk ka atraktivitet në shkolla, kurrë infrastrukturë më të mirë në shkolla nuk ka

pasur, pse nuk po shfrytëzohen palestrat e ndërtuara, fushat sportive, nuk mbahen gara ndërmjet nxënësve, prandaj fëmijët largohen nga shkolla, po e përsëris prapë, të shfrytëzohen sa më shumë palestrat e ndërtuara dhe fushat sportive nga nxënësit, ndoshta edhe iu kthehet interesimi për shkolla se gjendja me të vërtetë është shumë keq. Prandaj duhet të hartohet një plan më afatgjatë, 10 vjeçar, dhe t'i përmbahemi atij plani.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim Projekt-Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026.

Projekt-Plani i veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026 u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 4

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Raportin e punës së Drejtorisë për Shëndetësi për periudhën janar-dhjetor 2023.

Erseka Barani: Kam një pyetje për Drejtorin e DSH-së: cilat janë rezultatet dhe konkluzionet rreth vizitave sistematike mjekësore të nxënësve të shkollave fillore e të mesme të ulëta, si dhe të mesme të larta të Mitrovicës, cila ka qenë kostoja e këtij projekti dhe a ka një raport të detajuar lidhur me këto vizita?

Fahri Shabani: Raporti final ka kaluar të gjitha fazat, tash do t'i prezantohet edhe këshillit drejtues dhe pastaj do të vije në Kuvend për shqyrtim, raporti është i detajuar, do të publikohet edhe në faqen e Komunës, ka pasur implikime buxhetore, na gëzon fakti që shumica e nxënësve dalin se kanë gjendje të mirë shëndetësore. Përveç shkollave publike të Mitrovicës në këtë projekt janë përfshirë edhe nxënësit e shkollave shqipe në veri, Qendra burimore, qendra mësimore në Lagjen Fidanishte dhe një shkollë private.

Hysen Muzliukaj: Në raport ceket se po vazhdon renovimi i pjesërishëm i QMF-së në Zhabar, i cili parashihet të përfundojë në fund të muajit janar 2024, a ka përfunduar ky renovim?

Fahri Shabani: Renovimi ende po vazhdon dhe besoj që në fund të muajit të ardhshëm do të përfundoj.

Xhyljeta Imeri: Në raport ceket zgjerimi i rrjetit të ordinancave stomatologjike në QMF dhe AMF, unë kam një vërejtje dhe një shqetësim i cili është ngritur edhe nga qytetarët lidhur me këtë shërbim, këtë shqetësim e kam cekur edhe në mandatin e kaluar, fjala është për ndërrimin e mjekëve në disa QMF apo AMF, p.sh. në disa ambulanca këtë javë është një mjek ndërsa në javën tjetër ndërrohet mjeku, qytetari ka termin dhe në shumë raste ndodhë që mjeku edhe përkundër se i ka shënimet iu thotë pacientëve që unë nuk e di se çfarë ka punuar mjeku te ju, këtë shqetësim e kanë shprehur shumë qytetarë, prandaj unë mendoj që të kemi më pak ordinanca stomatologjike por të kemi shërbime çdo ditë dhe të kemi shërbime cilësore, jo të kemi kuantitet por të kemi kualitet.

Fahri Shabani: Ne kemi bërë zgjerimin e rrjetit të ordinancave stomatologjike në QMF dhe AMF sepse i kemi dhënë prioritet shëndetit oral duke pasur parasysh se gjitha raportet qoftë nga OBSH-ja, qoftë nga institucionet tjera relevante të cilat e nxjerrin popullatën e Kosovës në nivelin me shëndet jo të mirë oral, në nivel goxha shqetësues, e sidomos fëmijët e moshës shkollorë, prandaj i kemi dhënë kaq rëndësi shëndetit oral dhe shërbimit stomatologjike i kemi zgjeruar në ambulancat afër shkollës, jemi munduar që ta krijojmë

në lidhje të fortë në mes shkollës dhe QMF-së ose AMF-së, në mënyrë që nxënësit t'i shërojnë dhëmbët. Ne i kemi 20 stomatologë, sipas formulës ish dashur të jenë 12, specifikat e shpërndarjes së popullsisë në Mitrovicë na e vështirësojnë mbulimin e përditshëm të të gjitha QMF-ve dhe AMF-ve me stomatolog. QKMF-ja me sugjerimin tim është duke e vlerësuar gjendjen dhe në bazë të raporteve ditore të të gjitha qendrave dhe shërbimeve mjekësore që me e vlerësuar se sa ditë në javë duhet me shkuar stomatologu. Dihet se jemi ndër komunat e pakta që nga viti 2008 që japim shërbim të stomatologjisë 24 orë dhe kjo ndodhë vetëm në 3 komuna të Kosovës. Sa i përket asaj që ndërrohet stomatologu, ekzistojnë kartelat shëndetësore dhe aty janë shënimet për të gjithë pacientët.

Xhyljeta Imeri: Edhe unë thash që janë kartelat shëndetësore, po doktorët i neglizhojnë, unë po kërkoj të ketë shërbime cilësore, stomatologët po shkojnë në këto qendra, prandaj edhe t'i kryejnë shërbimet për çka janë të thirrur. Kam një rast konkret në Shipol kur një fëmije nuk i kanë kryer shërbim por i kanë thënë të shkojë në qytet për mjekim, kur ka ardhur në qytet i kanë thënë duhet të vish nesër ta hapësh kartelën mjekësore, prandaj atij fëmije tek të nesërmen pasi e ka hapur kartelën shëndetësor i është ofruar shërbimi. Prandaj prapë po e përsëris të kemi kualitet e jo kuantitet.

Fahri Shabani: Nuk përjashtohet rasti që ndonjë fëmijë edhe duhet me e udhëzuar te stomatologu i fëmijëve, sepse varet prej gjendjes së dhëmbit, kjo është e mundshme, ndërsa sa i përket neglizhencës dhe mos angazhimit, ne e kemi kutinë e ankesave, çdo qytetar i pakënaqur duhet të parashtojë ankesë, kemi Komisionin e Ankesave i cili i trajton ankesat. Komuna jonë ka themeluar edhe Këshillin e Pacientëve i cili i mbron të drejtat e pacientëve.

Vesel Neziri: E përgëzojë drejtorinë për rregullimin e infrastrukturës shëndetësore, shqetësuese është çështja e barnave dhe e analizave, në QKMF bëhen vetëm analizat e lira, ndërsa ato më të shtrenjta ju thuhet se nuk bëhen, duheni me i bërë privat. Jeta e qytetarit vërtetë është rënduar.

Fahri Shabani: Në QKMF kryhen të gjitha analizat të cilat parashihen me Udhëzimin Administrativ për kujdesin parësor shëndetësor, të tjerat që nuk parashihen me udhëzim nuk mund të kryhen në QKMF.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim Raportin e punës së Drejtorisë për Shëndetësi për periudhën janar-dhjetor 2023.

Raport i punës së Drejtorisë për Shëndetësi për periudhën janar-dhjetor 2023 u miratua unanimit (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

Pika 5

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.

Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024 u miratua unanimit (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 6

Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin lidhur me Kërkesën e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Kërkesën e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare.

Kërkesa e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare u miratua unanimitisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe e njëjta i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 11:05 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:


Merita PRETANI



Kryesuesja e Kuvendit


Vesa BROJA